



KËSHILLI I BASHKISË KORCË
VENDIM

NR 95 DATË 18.10.2010

MBI NDRYSHIMET NË STRUKTURËN E NDËRMARRJES SË
SHËRBIMEVE PUBLIKE

Këshilli i Bashkisë, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse, bazuar në Ligjin Nr.8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 32 ç, Ligjin nr.10190 datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", Udhëzimin Nr.1 datë 21.01.2010 "Për zbatimin e Buxhetit për Vitin 2010", Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" në V.K.M Nr. 693 datë 18.08.2010 "Për disa ndryshime në V.K.M Nr. 1619 datë 2.7.2008 "Për Klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore" të ndryshuar dhe në V.K.B Nr.14 datë 12.03.2010 "Mbi strukturën dhe pagat e administratës së ndërmarrjeve dhe institucioneve në vartësi të Bashkisë" mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve :

V E N D O S I

1. Në Sektorin e Gjelbërimit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike shtohen 11 pozicione punonjësi me pagë 19.000 lek dhe një pozicion brigadier me pagë kategoria IV-a dhe shtesa për pozicion 16.800 lekë. Me këta punonjës do të lidhen kontrata pune me afat të caktuar të cilat do të perfundojnë më datë 31-Mars-2011.
2. Ndryshon paga mujore e një brigadier ku nga P19 kalon në kategorinë IV-a me shtesë për pozicion 16.800 lekë.
3. Efektet financiare që rjedhin nga ndryshimet në strukturën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike do të përballohen nga nga fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të planifikuara në buxhetin e vitit 2010 të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të miratuara me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.20 datë 25.03.2010.
4. Të miratojë strukturën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me ndryshimet e sipërpërmendura si më poshtë

Nr	EMËRTIMI I POZICIONIT	Nr.fizik persona ve	Kategoria	Paga bazë	Shtesa pozicion	Kategori fikse
a.	b	c	d	e	f	h
1.	Drejtor	1	II.b	12000	46000	
2.	Nën/drejtor	1	III.b	12000	36750	
	Dega ekonomike	5				
	Përgjegjës	1	III.b	12000	31330	
	Llogaritar	1	IV.a	12000	16800	
	Magaznier	1	P.18			23625
	Specialist Privatizimi	1	P.18			29820
	Specialist për Prokurimet	1	IV.a	12000	16800	
4.	Shoferë	4	P.19			23625
5.	Shofer Manovrator	1	P.19			25200
6.	Spektori i Gjellbërimit	83				
	Përgjegjës	1	III.b	12000	20608	
	Specialist Gjellbërimit	1	IV.a	12000	16800	
	Brigadierë	3	P.19			25200
	Lulishtarë (specialist)	25	P.19			23100
	Punëtorë	40	P.19			21000
	Brigadierë	2	IV.a	12000	16800	
	Punëtorë	11	P.19			19.000
7.	Spektori mirëmb.rrugë trotuarë	15				
	Përgjegjës	1	III.b	12000	20608	
	Punëtorë Specialistë	8	P.19			23625
	Punëtorë	6	P.18			21000
8.	Spektori i ndriçimit dhe mekanik	12				
	Përgjegjës	1	III.b	12000	20608	
	Specialist Elektriçist	1	P.18			28035
	Elektriçist	5	P.18			24675
	Punëtorë Mekanikë	5	P.19			23100
9.	Shërbimi funeral	1				
	Punëtor Kartelist	1	P.19			23625
	Totali	123				

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse , Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI

